



Datë: 20.10.2025
Numër Protokolli: 6925/2025

Anr.1121/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Hava Fekaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1121/2025, të datës 12.06.2025, të parashtruar nga ankuesi, L.Sh, kundër organit të punësimit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.1121/2025, e datës 12.06.2025, e parashtruar nga ankuesi L.Sh.
- II. **Anulohet** në tërësi procedura e rekrutimit numër të referencës RN00017360, për Grupin e Përgjithshëm të Inxhinierisë, pozita Inspektor i Kontrolleve Teknike, në Divizionin për Inspektime të Kontrolleve Teknike-Ministria Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- III. **Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet për zbatimin e vendimit sikurse përcaktohet në pikën II të dispozitivi.
- IV. Zyrtari Kryesor Administrativ në Ministrinë Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës të përkujdeset për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil L.Sh, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 11.06.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar në Këshill më datë 12.06.2025, nën shenjë A.nr.1121/2025, kundër Njoftimit të datës 11.06.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për refuzimin e aplikacionit në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00017360, për pozitën e punës Inspektor i Kontrollleve Teknike, të shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.06.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministri e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje vetëm MMPHI), ndërsa, kjo e fundit, më datë 23.06.2025, ka përcjellë shkresat referuar çështjes në procedurë duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje të drejtë dhe meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3943/2025, të datës 11.06.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kopjen e patentshoferëve të ankuesit; Diplomën e kandidatit L.SH të Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina", Kontratën e Punës për Kohë të paktuar; Trustin pensional të ankuesit; Licencën e ankuesit si Inxhinier në qendrën e Kontrollimit Teknik të Automjeteve; Certifikatën e datës 05.06.2015; Certifikatën për pjesëmarrje në Trajnim të datës 13.07.2019; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.06.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 23.06.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Kopjen e kërkesës për rekrutim të stafit me Nr. Protokolli 1706 e datës 18.02.2025; Shpalljen e konkursit të datës 24.03.2025; e kandidatëve të aprovuar dhe lista e kandidatëve të refuzuar; Njoftimin e datës 22.05.2025; Njoftimin e datës 08.05.2025 për shtyrje të aftit të verifikimit paraprak edhe për 15 ditë; vendimin me nr. Protokolli 4212/15 i datës 27.05.2025; Akt emërimit të datës 01.10.2024 për A.D; Akt Emërimit të kandidatit A.RR; Akt Emërimit të kandidatit A.A i datës 01.07.2015; Akt Emërimit të kandidatit F.M, i datës 11.07.2015; Akt Emërimit të kandidatit R.H, Nr.74/2025 i datës 19.05.2025; Diplomë universitare me nr.02-1332/86-604 i vitit 1988; Certifikatë mbi Magjistrature e Shkencave Teknike ;Shkresë emërimi i kandidatit V.M; i datës 28.06.2002; Kontratë e punës për kandidatin V.M; Kontratën e punës për periudhën nga 01/06/2005 dhe mbaron me 30.05.2006; Kontratën e punës për periudhën nga 01/06/2006 dhe mbaron me 30.05.2009; Kontratën e punës për periudhën nga 01/06/2009 dhe mbaron me 31.05.2012; Të dhënat nga Fondi i kursimeve pensionale; Licenca e kandidatit V.M; Diplomën e kandidatit L.SH të Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina", Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, Certifikatat e Trajnimeve të ndryshme të mbajtura në institucionet; Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës me nr.prot.3352 i datës 10.04.2025; Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës me nr.Protokolli 3351 i datës 10.04.2025; Kopjen e Letërnjoftimit të kandidatit V.M; Plotësim ndryshimin e Akt Emërimit të kandidatit 21.07.2014; Plotësim ndryshimin e Akt Emërimit të datës 08.10.2013;Vendimin me nr. Protokolli 10650 i datës 24.12.2024; Vendimin me nr. Protokolli 8730 i datës 16.11.2017;Vërtetimin me nr.165/03 i datës 16.08.2017; Vërtetimin me nr.444/03 i datës 02.02.2016; Plotësim ndryshimin e Akt Emërimit të datës 03.02.2016;Plotësim ndryshimin e Aktit të Emërimit të datës 08/10/2013; Akt Emërimit të datës 17.01.2012.Aplikacionin e kandidatit V.M, i datës 15.04.2025;Kontratën e punës për kohë të paktuar; Kopjen e Letërnjoftimit; Pasqyrën e Trustit Pensional; Aplikacionin e kandidatit M.R i datës 27.03.2025; Vendimin e datës 19.05/2023 me nr.Ref26/2422; Diplomën e kandidatit M.R të Universitetit të Tetovës, Fakulteti i Shkencave të aplikantëve; në Prishtinë me të cilën kandidati i ka

përfunduar studimet më 24 shtator 2010, dhe mori titullin Maxhistër i komunikacionit; Diplomën e Studimeve Themelore Universitare të kandidatit M.R; Diplomën e Shkollës së Mesme; Aplikacionin e kandidatit A.M të datës 01.04.2025; Diplomën e Shkollës së Mesme të kandidatit A.M; Diplomën Universitare të kandidatit A.M të cilat i ka përfunduar më 14.07.2009;Licenca e Kandidatit A.M; Certifikata e trajnimeve të ndryshme të kandidatit A.M;E-maili i datës 18 qershor 2025; Testi Elektronik i kandidatit A.M; Njoftimi i datës 11.06.2025 për kandidatin fitues; Njoftimi i datës 05.06.2025, i listës se kandidateve të cilët e kanë kaluar testin me shkrim; Njoftimi i datës 22.05.2025. me të cilin ankuesit i është refuzuar aplikacioni; Formular i listës se ngushtë të aplikantëve; Aplikacioni i ankuesit i datës 04.04.2025; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në Intervistë M.R; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në Intervistë A. M; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CH0513; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CH08169; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CH 4694; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CH 5469; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CH 5469; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CN 7193; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CH 1011; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CN 7202; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CN 02538; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CN 9818; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CN 2923; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CN 8640; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CN 3551; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CH 8347; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CH0513; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CH5346; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CH0941; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CN 6383; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kod CN 6245; Vlerësimet e Eseve me pikë nga anëtarët e Komisionit të Pranimit, Vendimi

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se *ankesa është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, tutje MMPHI, më datë 24.03.2025, ka shpallë konkursin publik për pranim me Nr.Ref: RN00017360, për Grupin e Përgjithshëm të Inxhinierisë, pozita Inspektor i Kontrolleve Teknike, në Divizionin për Inspektime të Kontrolleve Teknike, 1 vend pune, më datë aplikimi 25.03.2025 deri 23.04.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, të cilit sipas njoftimit të datës 22.05.2025, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, i është refuzuar aplikacioni më arsyetimin së mungon dëshmia lidhur me përvojën e punës të lëshuar nga institucioni i punësimit përfshirë edhe subjektet biznesore private, e cila përcakton pozicionin punës dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozicion sipas kushteve të konkursit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se procedurat e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 7 të Rregullores 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil si dhe nenin 9 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka shqyrtuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën e pranimit më Nr.Ref: RN00017360, për pozitën Inspektor i Kontrollave Teknike. Rrjedhimisht, në kuptim të ushtrimit të autorizimeve ligjore të organit publik në procedurë të pranimit në shërbim civil, Kolegji i Këshillit nga administrimi shkresave të lëndës ka gjetur së pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së është e lirë që nga muaji qershor 2021 dhe se kjo pozitë ende vazhdon të ushtrohet me ushtrues detyre. Në fakt, për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen kontestuese, Kolegji ka trajtuar çështjen e kompetencës ligjore të ushtruesit të detyrës të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, vetëm në vështirësi të legjislacionit në fuqi gjegjësisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik (i aplikueshëm nga data 26.09.2023) si dhe referuar kohës nga shpallja e konkursit deri tek akti përfundimtar i kontestuar, andaj, mbi këtë bazë, Kolegji mori parasysh përcaktimet ligjore sipas nenit 35 të këtij ligji, i cili në mënyrë shprehimore parasheh se : *1 Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm.* Rrjedhimisht, më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë të gjitha institucionet publike në kuadër të kësaj edhe MMPHI-ja, kanë qenë të obliguara që emërimin e ushtruesit të detyrës për pozitën përkatëse të lirë t'a bëjnë në pajtim të plotë me kërkesat ligjore të parapara më këtë ligj, ndërsa, sipas provave të lëndës përkundër që pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së nuk ishte e plotësuar, ministri-ja i/e MMPHI-së nuk ka nxjerrë akt të ri për caktim të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, por kjo pozitë ushtrohej më zëvendësues sipas Vendimit Nr.225, të datës 07.06.2023, ku me pastaj më Vendimin nr.313 të datës 11.10.2024, A.M në pozitën e Drejtorit të Shpronësimit caktohet ushtrues i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, pozitë të cilën e ka ushtruar deri më datë 18.12.2024, ku më pastaj me Vendimin Nr.315, të datës 19.12.2024, të ministrit të MMPHI-së, I.B në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, caktohet ushtruese i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm pozitë të cilën ende e ushtron mbi bazën e vendimit të datës 19.12.2024.

Pra, mbi gjendjen e fakteve si me sipër rrjedhë së pozita e Sekretarit të Përgjithshme të MMPHI -së ishte ushtruar me tejkalim të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe si pasojë e kësaj autorizimi për shpalljen e procedurës më numër reference RN00017360 dhe themelimi i Komisionit të Pranimit janë veprime të ndërmarra nga ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së jashtë afatit ligjor 1 vjeçar të përcaktuar më nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Për më tepër, Kolegji i Këshillit mori parasysh konstatimet e Gjykatës Supreme sipas aktgjykimit P.A.nr.07/2025 të datës 10.06.2024,(i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 03.07.2024) lidhur me interpretimin dhe efektet juridike të nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-198 për Zyrtarët Publik, rrjedhimisht, Gjykata Supreme përmes kiji aktgjykimi ka konstatuar se: *“ Nga kjo dispozite rrjedhë qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një*

viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra ndërrimi i personit nuk e dhe nuk e rifillon afatin gjashtëmuor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon, stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi në udhëheqjen publike...,

Andaj, pas konstatimit se autorizimi për shpalljen e procedurës me numër reference RN00017360, dhe themelimi i Komisionit të Pranimit janë veprime të ndërmarra nga ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së jashtë aftit ligjor 1 vjeçar të përcaktuar me nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit këto veprime cilësohen si veprime të ndërmarra në mungesë të kompetencës ligjore dhe si të tilla në tërësinë e saj cenojnë ligjshmërinë e procedurës së kontestuar, kështu që, mbi këto rrethana ligjore procedura me nr.ref: RN00017360, konsiderohet si procedurë e paligjshme në kuptim të nenit 52, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Thënë si më lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, duke anuluar në tërësi procedurën e pranimit të shpallura sipas konkursit me numër reference RN00017360.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1121/2025

Hava Fekaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit L.Sh;
- Organit të Punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MMPHI-së;
- Arkivit të KPMSHCK-së.